




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF
GJAKOVA



Zyra e Prokurimit
Komuna e Gjakovës

Në bazë të nenit 72 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022, nenit 37 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK) në lidhje me kontratën me numër të prokurimit: 632-19-7128-5-2-1, numër të brendshëm 632-19-086-521 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-47492, për shkak të mos-përmbushjes së obligimeve kontraktuale nga ana e Kontraktorit: N.T.SH.“Viktory Com ” sh.p.k.- rr.”Tirana” Gjakovë, në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi ligjore, më dt. 21.09.2023, Zyrtari përgjegjës i prokurimit, Ju njofton:

NJOFTIM
Për ndërprerjen e Kontratës

Neni 37 i KPK përcakton se “Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës”. Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a) Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b) Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c) Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d) Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e) Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f) Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

Ju informojmë se kontrata e nënshkruar me datën 24.12.2019, me numër të prokurimit: 632-19-7128-5-2-1, numër të brendshëm 632-19-086-521 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-47492, me titull “Ndërtimi – asfaltimi i rrugëve në Tranzit dhe “Ali Ibra” në Komunën e Gjakovës”, ne mes të Komunës së Gjakovës dhe Punë kryesit N.T.SH.“Viktory Com.- Gjakovë, do të ndërpritet me date 22.09.2023.

Kontrata do të ndërpritet duke u bazuar në nenin 37, paragrafi 37.1 dhe 37.2 nën: a,e, dhe f, të Pjesa II e Kontratës – Kushtet e Përgjithshme.

Me datë 16.07.2020, pas përfundimit të procedurave për marrjen e lejes së ndërtimit për projektin në fjalë dhe pas buxhetimit, ju është lëshuar urdhëresa me shkrim nga menaxheri i projektit për fillimin e punimeve.

Gjatë vitit fiskal 2023, ju nuk keni punuar fare edhe pse ju janë lëshuar tri urdhëresa nga menaxheri i projektit për vazhdimin e punimeve:

Me datë 26.06.2023, ju është lëshuar urdhëresa e parë me shkrim nga menaxheri i projektit për vazhdimin e punimeve (gjeni bashkangjitur urdhëresën).

Me datë 21.07.2023, ju është lëshuar urdhëresa e dytë me shkrim nga menaxheri i projektit për vazhdimin e punimeve (gjeni bashkangjitur urdhëresën).

Me datë 02.08.2023, ju është lëshuar urdhëresa e tretë me shkrim nga menaxheri i projektit për vazhdimin e punimeve (gjeni bashkangjitur urdhëresën).

Përkundër vërejtjeve të shumta ju nuk ndërmorët veprime të nevojshme për përmirësim të dinamikës për realizimin e punëve, por përkundrazi ju nga fillimi i vitit fiskal 2023 deri me datë 28.08.2023, nuk jeni paraqitur në vend-punishte, nuk jeni përgjigjur urdhëresave të menaxherit të projektit, duke u treguar i pa përgjegjshëm për punën që kishit nisur duke e dëmtuar imazhin e institucionit të Komunës së Gjakovës.

Si Autoritet Kontraktues që kemi zhvilluar aktivitetin e prokurimit dhe kemi nënshkruar kontratën, ju informojmë se menjëherë pas datës 22.09.2023, do të ndërmarrim të gjitha veprimet konformë kushteve të kontratës.

Shkresës i bashkëngjiten të gjitha komunikimet e deritanishme dhe dëshmitë e mos realizimit të kontratës.

Me respekt,

Udhëheqës i zyrës së Prokurimit





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



DATE:	28.08.2023
REFERENC - E:	
PER/ZA/TO:	Zyrën Prokurimit, - z. Faton Gutaj
NGA/OD/FROM:	Menaxheri i Kontratës – Pjeter Marku
CC:	Drejtoria për Infrastrukturë – z. Shkumbin Kastrati Kryetari i Komunës – z. Ardian Gjini Operatori për Mbikëqyrje të Projekteve – AL Engineering shpk
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Rekomandimi për Ndërprerjen e Kontratës me titull: "Ndërtimi – Asfaltimi i rrugëve ne Tranzit dhe "Ali Ibra" me nr. identifikues: 632-19-086-521

Duke u bazuar në pikën 61.27 të Rregullores dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik dhe duke u bazuar në ecurinë e punimeve të kësaj kontrate po ju parashtroj këtë rekomandim për ndërprerje të kontratës me titull: "Ndërtimi – Asfaltimi i rrugëve ne Tranzit dhe "Ali Ibra" me nr. identifikues: 632-19-086-521 e lidhur me datë 24.12.2019, ndërmjet Komunës së Gjakovës dhe OE NSHT "VIKTORY COM"- Gjakovë

Arsyetimi:

- Kontrata është nënshkruar ne 24.12.2019, pas përfundimit të procedurave për marrjen e lejes së ndërtimit për projektin në fjalë, pas buxhetimit dhe me fillimin e punimeve iu është dhënë urdhëresë për fillim të punimeve operatorit me datë: 16.07.2020.
- Operatori Ekonomik për vitin fiskal 2023 nuk ka punuar fare, edhe pse ju kanë dhënë tri urdhëresa për vazhdimin e punimeve.
- Urdhëresa e parë e dt.26.06.2023
- Urdhëresa e dytë e dt.21.07.2023 dhe,
- Urdhëresa e tretë e dt.02.08.2023

Duke u bazuar nga ajo që u tha më lart ju rekomandoj që kjo kontratë të ndërpritet duke vepruar në bazë të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

Me Respekt!

KOMUNA E GJAKOVËS

DREJTORIA PËR INFRASTRUKTURË

Postal address: Nëna Terezë, Nr. 469 Gjakovë, Kosovë

Tel: +381 (0) 390 320 050

<http://kk.rks-gov.net/gjakove/>



Republika e Kosovës
Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Komuna Gjakovë
Opština Djakovica
Municipal of Gjakova

DATE:	26.06.2023
PËR/ZA/TO:	N.T.SH. "Victory.Com", Gjakovë
CC:	• Zyrën e Prokurimit – z. Faton Gutaj • Drejtoria e Infrastrukturës – z. Shkumbin Kastrati • Organin Mbikëqyrës "AL - Engineering" Prishtinë - z. Valdrin Zenuni • Kryetari i Komunës, z. Ardian Gjini
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM	Projekt Menaxheri – z. Pjeter Marku
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Urdhëresës për vazhdimin e punimeve të tenderëve me titull: Ndërtimi i rrugës Lipovec Goden Ndërtimi rrugës së Radoniqit Ndërtimi i rrugëve në "Tranzit" dhe "Ali Ibra" Ndërtimi i rrugës Cufa Doli

I nderuar

Pas takimit me Udhëheqesin e Zyres së Prokurimit dhe Projekt Menaxherin ju jeni dakorduar për fillimin – vazhdimin e punimeve të kontratave në fjalë.

Andaj Urdhëroheni nga zyra e Menaxherit për vazhdimin e punimeve më së largu gjer me datën 03.07.2023.

Duhet të njoftoni Njësinë Kërkuuese, Projekt Menaxheri dhe Zyra e Prokurimit për datën e fillimit të e punimeve.

Me respect!



Republika e Kosovës
Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Komuna Gjakovë
Opština Djakovica
Municipal of Gjakova

DATE:	21.07.2023
PËR/ZA/TO:	N.T.SH. "Victory.Com", Gjakovë
CC:	• Zyrën e Prokurimit – z. Faton Gutaj • Drejtoria e Infrastrukturës – z. Shkumbin Kastrati • Organin Mbikëqyrës "AL - Engineering", Prishtinë - z. Valdrin Zenuni • Kryetari i Komunës, z. Ardian Gjini
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM	Projekt Menaxheri – z. Pjeter Marku
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Urdhëresës për vazhdimin e punimeve të projektëve me titull: Ndërtimi i rrugës Lipovec Goden Ndërtimi rrugës së Radoniqit Ndërtimi i rrugëve në "Tranzit" dhe "Ali Ibra" Ndërtimi i rrugës Cufa Doli

I nderuar!

Pas urdhëresës së dhënë me dt.26.06.2023 , ju si Kompani ende nuk keni filluar me vazhdimin e punimeve të projektëve në fjalë.

Andaj **Urdhëroheni**, se që nga dita e Hane (dt.24.07.2022) të filloni me vazhdimin e punimeve në projektet e cekura më lartë.

Për fillimin e punimeve duhet të na njoftoni me kohë!

Me respect!



Republika e Kosovës
Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Komuna Gjakovë
Opština Djakovica
Municipal of Gjakova

DATE:	02.08.2023
PËR/ZA/TO:	N.T.SH. "Victory.Com", Gjakovë
CC:	• Zyrën e Prokurimit – z. Faton Gutaj • Drejtoria e Infrastrukturës – z. Shkumbin Kastrati • Organin Mbikëqyrës "AL - Engineering", Prishtinë - z. Valdrin Zenuni • Kryetari i Komunës, z. Ardlan Gjini
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Projekt Menaxheri – z. Pjeter Marku
TEMA/SUBJEKTI/SUBJECT:	Urdhëresës për vazhdimin e punimeve të Projektëve me titull: Ndërtimi i rrugës Lipovec Godep Ndërtimi rrugës së Radoniqit Ndërtimi i rrugëve në "Tranzit" dhe "Ali Ibra" Ndërtimi i rrugës Cufa Doli

I nderuar!

Pas dy urdhëresave të dhëna me dt. 26.06.2023 dhe me dt. 21.07.2023, ju si Kompani ende nuk keni filluar me vazhdimin e punimeve të projektëve në fjalë.

Andaj Urdhëroheni, që në një afat sa ma të shkurt të mundur të filloni me vazhdimin e punimeve në projektet e cekura më lartë, ose në të kundërtën dorëzoni arsyetim me shkrim për mos vazhdim të punimeve ose për ndonjë pengesë tjetër që e keni.

Nëse edhe pas urdhëresës së tretë nuk filloni me vazhdimin e punimeve, unë si menagjer i projektëve sipas ligjeve në fuqi, jam i detyruar që të bëjë përgaditjen e rekomandimit Zyrës së Prokurimit për ndërprerjen e Kontratave.

Për fillimin e punimeve duhet të na njoftoni me kohë!

Me respect!